



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË

Korçë, më 23/11/2017

TAKIM PËR BUXHETIMIN ME PJESËMARRJE ME BANORËT E NJËSISË
ADMINISTRATIVE VOSKOPOJË

Bazuar në Ligji 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, Ligji 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe Ligji 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, në vijim të procesit të përgatitjes së projektbuxhetit për vitin 2018, zhvilluam një takim në datë 23/11/2017 me banorët e Njesisë Administrative Voskopojë.

Në takim morën pjesë: Zv/Kryetari i Bashkisë Ermal Saraçi, staf i bashkisë, banorë të njesisë administrative Voskopojë dhe organizata të tjera të interesuara, për të vendosur së bashku prioritetet e investimeve me qëllim përmirësimin e jetesës në çdo fshat ku ata jetojnë. Gjatë takimit, banorët sollën në vëmendje dhe shqyrtuan së bashku disa kërkesa dhe problematika të zonës, të cilat janë të listuara si më poshtë:

- Rikonstruksionin ose ndërtimin e ujësjellësave dhe kanalizimeve në fshatrat e njesisë administrative Voskopojë.
- Çështje të ndryshme në lidhje me procesin e marrjes së tokave në pronësi.
- Rehabilitimi i disa rrugëve të brendëshme në fshatin Voskopojë.
- Ndërtimin e një parku çlodhës, kopshtit dhe shkollës në fshatin Voskopojë.
- Ndërtimin e një muzeumi që të përfaqësojë historinë e zonës së Voskopojës.
- Rehabilitimin dhe sistemimin e rrugëve hyrëse dhe të brendëshme në fshatrat Lavdar, Gjonomadh, Shpëskë, Krushovë.
- Përmirësimin e ndriçimit në fshatra.
- Vazhdimin e procesit të pastrimit të lumenjve, kanaleve kullues dhe vaditës.
- Rehabilitimin e sistemimin e rrugëve midis parcelave bujqësore.

Buxheti me pjesëmarrje është një mekanizëm që lejon qytetarët të marrin pjesë në vendimmarrje dhe ngritjen e transparencës në procesin e hartimit të buxhetit.















ilim

Rrujet rurak
Gjonamadh

Kanalizime
Gjonamadh

Sëhtje
Probleme
(taka)

lumenjve
Gjonamadh

Uji i pijshom
Gjonamadh

Shkollë
kopçisht
Vaskopaje

Mungese
parku

Hapje e nje
Muzeumi

Kanalizime
shqipëri

Probleme
rreze
reze